



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2126/17 Prot.

Tiranë, më 16.09 2025

VENDIM

Nr. 99 datë 16.09 2025

PËR

NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
DHE KOLEGJIT UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"

Mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma "c" dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', në nenin 20, pika "s" të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe në Vendimin e Rektoratit nr. 97 datë 11/09/2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 16/09/2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes të bashkëpunimit për projekte dhe kërkim shkencor ndërmjet **Universitetit të Sporteve të Tiranës** dhe **Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"**.
2. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nënshkrimit Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA



DRAFT

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
PËR PROJEKTE DHE KËRKIMIN SHKENCOR**

mes

Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

dhe

Universitetit të Sporteve të Tiranës

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (në vijim “Marrëveshja”) lidhet dhe hyn në fuqi ndërmjet:

Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT), një institucion privat i arsimit të lartë në Tiranë, Shqipëri, i përkushtuar t’u ofrojë studentëve një arsim të bazuar në aftësi praktike, vlera etike, aftësi për zgjidhjen kritike dhe analitike të problemeve, krijimtari, inovacion dhe lidërsip. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT), është person juridik i themeluar nga C.I.T shpk., regjistruar në QKR me NIPT nr. L11614010R, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Ismail Kocayusufoglu.

Dhe

Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), një institucion publik i arsimit të lartë, i vetëm i këtij lloji në Republikën e Shqipërisë, i krijuar në vitin 1958, në funksion të përgatitjes së mësuesve të edukimit fizik, specialistëve të sportit, të rekreacionit, të fitnesit dhe aktivitetit fizik për shëndet, menaxherëve të sportit dhe turizmit si dhe të specialistëve në fushën e rehabilitimit.

Me qëllim forcimin e marrëdhënieve miqësore ndërmjet Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT), Tiranë, Shqipëri dhe Universitetit të Sporteve të Tiranës, Shqipëri. Palët kanë vendosur të krijojnë një lidhje formale për të nxitur bashkëpunimin në arsim dhe kërkim shkencor në të mirë të të dy institucioneve dhe studentëve të tyre, dhe kanë rënë dakord të nënshkruajnë një Marrëveshje Bashkëpunimi për bashkëpunim akademik ndërmjet CIT dhe UST (në vijim “Marrëveshja”).

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është të nxisë dhe realizojë shkëmbimin e stafit akademik dhe kërkuesve shkencorë, mobilitetin e studentëve, bashkëpunimin në kërkimin shkencor, shkëmbimin kulturor, si dhe forma të tjera të bashkëpunimit. Kjo synon të forcojë miqësinë midis të dyja palëve, të promovojë kapacitetet e tyre në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor, si dhe të rrisë ndikimin e tyre në arenën ndërkombëtare.

Objekti i Marrëveshjes

Objekti i kësaj Marrëveshje është shprehja e vullnetit dhe angazhimit të dy institucioneve të arsimit të lartë për të bashkëpunuar, në përputhje me kërkesat ligjore dhe institucionale, planet strategjike dhe burimet në dispozicion. Ky bashkëpunim synon të eksplorojë dhe zhvillojë forma të ndryshme të bashkëpunimit, që përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- Pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore shkencore dhe bashkëpunime të tjera;
 - Shkëmbim njohurish përmes mësimdhënies, materialeve dhe fushave të tjera të përshtatshme;
 - Shkëmbim eksperiencash dhe ekspertizash;
 - Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në përmbushje të qëllimeve të kësaj marrëveshje;
 - Organizimin e konferencave, seminare dhe leksione të hapura nga të dy palët;
 - Publikime në revista kërkimore-shkencore;
 - Forma të tjera të mundshme zhvillimi dhe bashkëpunimi që do të ishin me përfitim të ndërsjellë për të dy palët, duke rënë dakord paraprakisht për organizimin e tyre dhe personat përgjegjës;
 - Bashkëpunim në kuadër të projektit “Iniciativa në Bashkëpunim, Kërkim dhe Inovacion në Universitetet e Ballkanit Perëndimor” (ICRI-WB), një projekt i drejtuar nga CIT dhe financuar nga AKKSHI në kuadër të Projekteve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) për vitin 2025-2027. Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) duke pranuar të bëhet pjesë e platformës rajonale të krijuar në kuadër të projektit ICRI-WB do të kontribuojë sipas pikave më poshtë:
- a) Të bashkëpunojnë për të dhënat që do të mundësojnë krijimin e profilit të UST në faqen e platformës;
- b) Të promovojnë platformën tek stafi akademik dhe të nxisin regjistrimin e tyre në të;
- c) Të bashkëpunojnë për përditësimin e thirrjeve për projekte dhe bashkëpunime të ndryshme;

Palët bien dakord të caktojnë një person përgjegjës nga secili institucion, i cili do të ketë detyrën për të integruar dhe përditësuar të dhënat zyrtare në platformë, dhe për të koordinuar bashkëpunimin:

o Personi përgjegjës për CIT: **Msc. Muhamedali Kura**, Email: Muhamedali.Kura@cit.edu.al; +355 68 68 08 387

o Personi përgjegjës për UST: **Dr. Elona Mehmeti**, email: emehmeti@ust.edu.al; +355 67 203 9201

Neni 1

Përpara se të zbatohen ndonjë nga këto aktivitete, palët bien dakord që detajet për secilin aktivitet do të përcaktohen në marrëveshje të veçanta, të cilat do të jenë të miratuara nga të dyja palët.

Gjithashtu, të dyja palët angazhohen të respektojnë në mënyrë të plotë çdo kërkesë ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, lidhur me shkëmbimin dhe transmetimin e të dhënave, pajisjeve, informacionit, teknologjisë apo personelit, në përmbushje të qëllimeve të përcaktuara më sipër.

Neni 2

Të dyja palët do të shqyrtojnë në mënyrë të ndërsjellë burime të ndryshme financimi institucionale, qeveritare dhe private për të mbështetur programet që synojnë të zhvillojnë. Çdo aktivitet që kërkon angazhime financiare nga cilado palë do të diskutohet bashkërisht, për të siguruar që të dyja palët bien dakord për marrëveshjet financiare përpara fillimit të atij aktiviteti.

Neni 3

Të dyja palët bien dakord që përdorimi i emrit, logos apo çdo simboli identifikues të njërës palë nga pala tjetër, në lidhje me ndonjë program apo aktivitet të propozuar, nuk lejohet të përdoret pa miratim paraprak me shkrim nga pala përkatëse.

Neni 4

Prona intelektuale (PI) e krijuar në mënyrë të përbashkët në kuadër të kësaj Marrëveshje do të jetë në bashkëpronësi të të dyja palëve, përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe me shkrim.

Secila palë mban të drejtën e pronësisë mbi pronën intelektuale dhe materialet që i ka krijuar ose zotëruar përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Çdo përdorim, riprodhim apo komercializim i pronës intelektuale të zhvilluar në mënyrë të përbashkët kërkon pëlqimin paraprak dhe të ndërsjellë të të dyja palëve.

Palët angazhohen të respektojnë markat tregtare, të drejtat e autorit dhe patentat e njera-tjetrës në të gjitha aktivitetet e bashkëpunimit.

Neni 5

Kjo është një marrëveshje e plotë ndërmjet palëve, dhe asnjë deklaratë, premtim apo marrëveshje tjetër, goftë verbale apo në ndonjë formë tjetër, nuk do të ketë fuqi apo efekt, përveç nëse palët bien dakord ndryshe me

shkrim pas datës së kësaj Marrëveshje. Çdo shtesë, ndryshim apo rishikim i kësaj Marrëveshje duhet të bëhet vetëm me shkrim dhe me pëlqimin e ndërsjellë të të dyja palëve.

Neni 6

Kjo Marrëveshje nuk përbën një instrument për krijimin e marrëdhënieve juridike apo financiare ndërmjet Palëve. Marrëveshja synon të zhvillojë një bashkëpunim formal dhe të dobishëm për të dyja palët në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor. Asnjë Palë nuk do të kryejë shpenzime në emër të Palës tjetër. Secila Palë do të jetë përgjegjëse për shpenzimet e veta, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe paraprakisht përpara zbatimit të aktiviteteve në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Secila Palë do të caktojë një person ose një zyrë përgjegjëse që do të veprojë si pikë kontakti për zbatimin e kësaj Marrëveshje.

Për CIT, personi i kontaktit do të jetë **Anisa Balla** (Adresa: Rr. Xhanfize Keko, Nr. 12, Kompleksi Xhura, Tiranë, Shqipëri; Tel: +355 67 404 2042; Email: rectoroffice@cit.edu.al).

Për UST, personi i kontaktit do të jetë **Msc. Safiola Çarçani (Shabanaj)** (Adresa: Rr. Muhamet Gjollësja, Tiranë, Shqipëri; Tel: +355 67 409 1443; Email: sshabanaj@ust.edu.al).

Neni 8

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit dhe do të jetë e vlefshme për një periudhë 5(pesë) vjeçare. Për të vlerësuar progresin dhe përmbushjen e objektivave, Marrëveshja do të rishikohet periodikisht çdo pesë vjet. Ajo mund të zgjatet për një periudhë të re pesëvjeçare me miratimin me shkrim të të dyja Palëve.

Neni 9

Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe në dy kopje origjinale, ku secila palë mban një kopje. Të dy kopjet kanë të njëjtën vlerë ligjore dhe janë autentike.

Neni 10

Çdo Palë ka të drejtë të ndërpresë këtë Marrëveshje duke i komunikuar Palës tjetër me shkrim, së paku tridhjetë (30) ditë para datës së ndërprerjes. Aktivitetet që janë në proces në momentin e ndërprerjes do të lejohen të përfundojnë sipas planit, përveç në rast se Palët bien dakord ndryshe me shkrim.

Neni 11

Palët bien dakord që kjo Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me parimet e besimit të mirë, drejtësisë dhe me respekt të plotë ndaj interesave reciproke të tyre. Në rast se gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje lind ndonjë mosmarrëveshje që mund të ndikojë negativisht në interesat e ndonjë Pale, Palët do të përpiqen ta zgjidhin miqësisht. Në rast se mosmarrëveshjet nuk mund të zgjidhen miqësisht brenda një periudhe të arsyeshme, kjo Marrëveshje do të konsiderohet e ndërprerë me efekt të menjëhershëm, pa dëmtuar të drejtat dhe detyrimet që kanë lindur para ndërprerjes.

Palët

Instituti Kandez i Teknologjisë

Firmosur nga:

Prof. Dr. Ismail Kocayusufoglu

Rektor

Data:

Universiteti i Sporteve të Tiranës

Firmosur nga:

Prof. Dr. Agron Kasaj

Rektor

Data:
